



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2031/ 9 prot.

Datë 15.08.2024

V E N D I M
Nr. 1063/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.08.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike Marreveshje Kuader me 1 (nje) operator ekonomik fitues per secilin Lot – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 12 muaj”, me **REF-06666-05-27-2024**, me objekt “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote, **Loti 3: “Blerje bukë” me nr.REF-06681-05-27-2024**, me fond limit **5 871 067,58** (pesë milion e teteqind e shtatedhjetë e nje mijë e gjashtëdhjetë e shtate presje pesedhjetë e tete) **lekë pa TVSH** dhe vlere totale **7 045 281,096** (shtatë milion e dyzet e pese mije e dyqind e tetedhjetë e nje presje zero nentedhjetë e gjashte) **leke me TVSH ose fondi limit në Euro 58 430,21** pesedhjetë e tete mije e katerqind e tridhjetë presje njezet e nje) **Euro** ((sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 27.05.2024), zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.

Ankimues:

Operatori ekonomik “4 S” SHPK me Nipt. L64425401K.
Adresa: Lagjia Xhevdet Nepravishta, Rr. Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr. 23, Lushnje.

- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.
Adresa: Lagja "29 Nëntori", Rruga "Kastriot Muço", Fier.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik "KADRA" SHPK, me NIPT K31321008J dhe adresë Tiranë kamëz, Laknas, Rruga Nënë Tereza, banesë private me Nr. Pasurie 180/29, Zona Kadastrale 2372.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

- I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.05.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e mbi kufirin e lartë monetar”, **Loti 3: “Blerje bukë” me nr.REF-06681-05-27-2024**, me fond limit **5 871 067,58** (pesë milion e teteqind e shtatedhjetë e nje mijë e gjashtëdhjetë e shtate presje pesedhjetë e tete) **lekë pa TVSH** dhe vlere totale **7 045 281,096** (shtatë milion e dyzet e pese mije e dyqind e tetedhjetë e nje presje zero nentedhjetë e gjashtë) **leke me TVSH ose fondi limit në Euro 58 430,21** (pesedhjetë e tete mije e katerqind e tridhjetë presje njezet e nje) **Euro** ((sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 27.05.2024), zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.

II.2. Në datë 27.06.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 12.07.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- “4 S” SHPK	4,403,310 lekë	skualifikuar
- “3-SH” SHPK	4,693,688 lekë	skualifikuar
- “KADRA” SHPK	4,804,683.20 lekë	kualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “4 S” SHPK është njoftuar për arsyen e skualifikimit të ofertës së tij si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës 4 S SHPK me NUIS L64425401K, konstatoi mangësit si më poshtë: Referuar Shtojcës 7 të DST-së përcaktohet se Operoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojnë per me shumë se nje lot, duhet te plotesojne kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë. Operatori ekonomik 4 S SHPK rezulton të ketë ofertuar në tre lote. Konkretisht: -Loti 1: “Blerje bulmeti dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 9 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 1), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.” -Loti 3: “Blerje bukë” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se 1 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 3), që është realizuar gjatë tri viteve të

fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.” -Loti 5: “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 5 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 5), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.” Në përmbushje të këtij kriteri OE 4 S SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlera e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar”.

II.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me 19.07.2027 është publikuar “njoftimi i fituesit paraprak”, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 40, datë 22.07.2024, ku është shpallur fitues operatori ekonomik “KADRA” SHPK.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/4359, datë 22.07.2024 dhe me Nr.2031/2024 Prot., datë 22.07.2024 e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2031/2 prot., datë 23.07.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Me datë 29.07.2024 operatorit ekonomik “KADRA” SHPK ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike formularin e paraqitjes së argumentave në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së i cili u protokollua me tonën me nr.2031/3 prot., datë 29.07.2024.

II.9. Me datë 02.08.2024 autoriteti kontraktor ka paraqitur në sistemin e ankesave elektronike shkresën nr. 411/47 prot., datë 01.08.2024 protokolluar me tonën me nr. 2031/4 prot., datë 02.08.2024, bashkëlidhur së cilës gjendet vendimi nr. 411/43 datë 01.08.2024 i KSHA nga ku rezulton, se ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues

II.10. Informacionin më sipër mbi trajtimin e ankesës së autoritetit kontraktor e ka dërguar edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr.2031/5 prot., datë 05.08.2024.

II.11. Me shkresën nr.8364 prot., datë 13.08.2024, protokolluar me tonën me nr.2030/6 prot., dtaë 15.08.2024, me objekt “Kërkesë për përshpejtim të trajtimit të ankesave në mënyrë të

pavarur për procedurat e prokurimit me objekt Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont” per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “4 S” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës 4 S SHPK me NUIS L64425401K, konstatoi mangësit si më poshtë: Referuar Shtojcës 7 të DST-së përcaktohet se Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojnë per me shumë se nje lot, duhet te plotesojne kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë. Operatori ekonomik 4 S SHPK rezulton të ketë ofertuar në tre lote. Konkretisht: -Loti 1: “Blerje bulmeti dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlера e kerkuar eshte jo me pak se 9 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 1), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.” -Loti 3: “Blerje bukë” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlера e kerkuar eshte jo me pak se 1 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 3), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.” -Loti 5: “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlера e kerkuar eshte jo me pak se 5 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 5), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.” Në përmbushje të këtij kriteri OE 4 S SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlера e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar”.” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, loti 3. “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 *Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlера e kerkuar eshte jo me pak se 1 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së*

përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 3), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

***a-** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

ose

***b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, loti 3. “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kërkesa si më poshtë:

Shënim: Operatoret ekonomike të cilat do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për më shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikës 2.2.2., dhe përvojën e ngjashme sipas pikës 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë se operatori ekonomik “4 S ” SHPK në përmbushje të kriterit dhe të kërkesës më sipër ka dorëzuar faturat si më poshtë:

- Faturë tatimore me nr. 133/2023, datë 31.05.2023, me vlerë pa Tvsh xxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 201/2023, datë 30.06.2023, me vlerë pa Tvsh xxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 271/2023, datë 31.07.2023, me vlerë pa Tvsh xxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 453/2023, datë 29.09.2023, me vlerë pa Tvsh xxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 616/2023, datë 31.10.2023, me vlerë pa Tvsh xxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 795/2023, datë 30.11.2023, me vlerë pa Tvsh xxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 1062/2023, datë 29.12.2023, me vlerë pa Tvsh xxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 163/2023, datë 31.01.2024, me vlerë pa Tvsh xxxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 385/2024, datë 29.02.2024, me vlerë pa Tvsh xxxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 574/2024, datë 29.03.2024, me vlerë pa Tvsh xxxxx lekë*
- Faturë tatimore me nr. 832/2024, datë 30.04.2024, me vlerë pa Tvsh xxxxx lekë*

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.6. Neni 39 “Ndarja e kontratave në lote”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.1.7. Në nenin 40 pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.1.8. Në nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t’i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t’i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.”

III.1.9 . Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt- ankimi rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara, baza e të dhënave të ankesave si dhe raporti i auditit në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se operatori ekonomik ankimues “4 S” SHPK është ofertues në Lotin I, Lotin III dhe në Lotin V, njëkohësisht dhe ankimues për të Lotin III dhe në Lotin V, ndërsa për lotin I është shpallur fitues (referuar raportit të auditit si dhe Formularit të Njoftimit të Njoftimit të fituesit paraprak, publikuar në buletin nr.40, datë 22.07.2024). Nga ky verifikim Komisioni arrin në konkluzion, se siç u theksua më sipër operatori ekonomik ankimues është ofertues në tre lote (loti I, III dhe V), ku arsyeja e skualifikimit për lotin III është: *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës 4 S SHPK me NUIS L64425401K, konstatoi mangësit si më poshtë: Referuar Shtojcës 7 të DST-së përcaktohet se Operatoret ekonomike të cilat do të paraqesin ofertat/konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe përvojën e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë. Operatori ekonomik 4 S SHPK rezulton të ketë ofertuar në tre lote. Konkretisht: - Loti 1: “Blerje bulmeti dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kerkuar është jo më pak se 9 000 000 leke pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 1), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” -Loti 3: “Blerje bukë” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kerkuar është jo më pak se 1 000 000 leke pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin*

3), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit të kontrates.” - Loti 5: “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kerkohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se 5 000 000 leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 5), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit të kontrates.” Në përmbushje të këtij kriteri OE 4 S SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlera e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar”.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi në sistemin e prokurimeve elektronike, por edhe kthim-përgjigjes së autoritetit kontraktor dhe përmbajtjes së ankesës rezulton se operatori ekonomik ankimues “4 S” SHPK ka ofertuar dhe dorëzuar si dokumenatcion në përmbushje të kriterit dhe kërkesës më sipër të autoritetit kontraktor faturat e cituara në pikën III.1.3. të këtij vendimi ku rezulton se vlera në total e tyre për lotin III është xxxxx lekë pa TVSH. Autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit pika 2.3.1 e kriterëve të veçanta të kualifikimit për lotin I, III dhe IV respektivisht ka përcaktuar që për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit të kontrates dhe vlera e kwrkuar është jo më pak se 9 000 000 leke pa TVSH (për lotin I), jo më pak se 1.000.000 lekë pa TVSH për lotin III dhe jo më pak se 4 000 000 lekë pa TVSH (për lotin V). Nga ana tjetër gjithashtu ka kërkuar që: **“Shënim: Operatoret ekonomike te cilet do te paraqesin ofertat/ konkurrojne per me shumë se nje lot, duhet te plotesojne kriteret e veçanta,xhiron vjetore sipas pikes 2.2.2., dhe pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojne.”**

Referuar hartimit të kriterit të vecantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 për kontratat e ngjashme dhe vlerës së kërkuar për lotet ku ankimuesi ka paraqitur ofertën e tij (për lotin I vlera e kerkuar eshte jo me pak se 9 000 000 leke pa TVSH, për lotin III jo më pak se 1.000.000 lekë pa TVSH dhe për lotin V jo më pak se 5 000 000 lekë pa TVSH), si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor që operatoret ekonomike te cilet do të paraqesin ofertat/ konkurrojne për më shumë se nje lot, duhet të plotesojnë pervojen e ngjashme sipas pikes 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojne, vlera e faturave të paraqitura nga ankimuesi për lotin III objekt ankimi si dëshmi e furnizimeve të ngjashme të kryera brenda tre viteve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës duhet të jo më pak se shuma e vlerës së kontratave të ngjashme të kërkuar për lotin I, lotin III dhe për lotin V ku ankimuesi është ofertues të marra së bashku, pra jo më pak se 15 000 000 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit publik vlerëson se, nëse operatori ekonomik ofertues paraqet fatura të ndryshme për lote të ndryshme, atëherë vlera e tyre duhet të jetë jo më pak se vlera e kërkuar për lotin përkatës dhe jo vlera si shumatore e loteve për të cilat konkurron. Ndërkohë nga verifikimi i vlerës së faturave të paraqitura nga ankimuesi në SPE për lotin III, në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 sipas kërkesës më sipër të autoritetit kontraktor është xxxxxx lekë pa TVSH, ndërsa për lotin V është në vlerën xxxxxx lekë pa tvsh. Vlen të theksojmë se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues janë të ndryshme për lotet në të cilat ka konkurruar.

Sa i përket faturave të dorëzuara në përmbushje të kriterit 2.3.1 të lotit I, ku operatori ekonomik është ofertues, KPP gjykon se, vlera e tyre plotësohet për aq kohë sa, nga ana e autoritetit kontraktor operatori ekonomik ankimues është shpallur fitues për këtë lot (referuar raportit të auditit si dhe Formularit të Njoftimit të fituesit paraprak, publikuar në buletin nr.40, datë 22.07.2024).

Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “4 S” SHPK është në kushtet e përmbushjes së pikës 2.3.1 të kriterëve të vecanta të kualifikimit lidhur me furnizimet e mëparshme të ngjashme sipas kërkesës së përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se **“Operatorët ekonomike të cilët do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë përvojën e ngjashme sipas pikës 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.”** KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ankimuesit e ka bërë jo në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke skualifikuar në këtë mënyrë operatorin ekonomik ankimues i cili disponon dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor. Për sa kohë që operatori ekonomik ankimues është ofertues në tre lote (loti I, loti III dhe loti V) dhe për përmbushjen e këtij kriteri, për lotin III dhe Lotin V, nga verifikimi i faturave të paraqitura në SPE ka paraqitur fatura të ndryshme për lotet respektive, me vlerë jo më pak se vlera e kërkuar për secilin lot, pra jo më pak se 1 000 000 lekë pa TVSH për lotin III dhe jo më pak se 5 000 000 lekë pa TVSH për lotin V, kriteri konsiderohet i përmbushur. Ndërsa sa i përket faturave të paraqitura për lotin I, sikurse u theksua më lart, KPP vlerëson se vlera e tyre plotësohet, për aq kohë sa, nga ana e autoritetit kontraktor është vlerësuar jo vetëm si ofertë e kualifikuar, por edhe fituese e këtij loti.

Sa më sipër, KPP vlerëson, se operatori ekonomik ankimues ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme në vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues arrin të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur -Mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike Marreveshje Kuader me 1 (nje) operator ekonomik fitues per secilin Lot – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 12 muaj”, me **REF-06666-05-27-2024**, me objekt “Blerje produkte ushqimore për kopshtet, çerdhet, konviktin dhe shkollen Horizont”per vitin 2024, e ndare ne 5 Lote, **Loti 3: “Blerje bukë” me nr.REF-06681-05-27-2024**, me fond limit **5 871 067,58** (pesë milion e teteqind e shtatedhjetë e nje mijë e gjashtëdhjetë e shtate presje pesedhjetë e tete) **lekë pa TVSH** dhe vlere totale **7 045 281,096** (shtatë milion e dyzet e pese mije e dyqind e tetedhjetë e nje presje zero nentedhjetë e gjashtë) **leke me TVSH ose fondi limit në Euro 58 430,21**pesedhjetë e tete mije e katerqind e tridhjetë presje njezet e nje) **Euro** ((sipas kursit të këmbimit nga BSH datë **27.05.2024**), zhvilluar më datë 27.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Fier.
 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “4 S” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar atë.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4 S” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri